



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.440/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Labinot Halilaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Gllogocit, nga subjekti politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL) të paraqitur kundër vendimit Nr.01/3243-2025, të datës 05.11.2025 për shpalljes se rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal në Gllogoc dhe parregullsive gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 14.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET e pasafateshme ankesa e parashtruar nga Labinot Halilaj, kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Gllogocit, nga subjekti politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL), ZL.Anr.440/2025, e datës 13.11.2025, të paraqitur kundër vendimit Nr.01/3243-2025, të datës 05.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal në Gllogoc dhe parregullsive gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 13.11.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.440/2025, e datës 13.11.2025 të cilën e ka parashtruar përmes postës me datë 06.11.2025, Labinot Halilaj kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Gllogocit, nga subjekti politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL), me të cilën pretendon se duhet të ketë hetim dhe rinumërim të tërësishëm të votave për shkak të parregullsive të shumta të evidentuara gjatë dhe pas procesit të votimit e numërimit në Komunën e Gllogocit të cilat kanë rezultuar me vendime të padrejta e të cilat bien ndesh me vullnetin e votuesve dhe cenojnë rëndë demokracinë, të drejtën e votës e cila është e drejtë fundamentale, e garantuar me Kushtetutën tonë dhe me të gjitha konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Me tutje, në ankesë ka pretenduar se, ka pasur parregullsi në procesin e numërimit në QNK në Gllogoc, ku procesi i numërimit ishte zhvilluar me shkelje të dukshme dhe të vazhdueshme procedurale si ndërprerje të kamerave të sigurisë gjatë fazave të numërimit: ndërprerje të sistemit të futjes së të dhënave në momente kyçe: mungesë e formularëve origjinalë për vëzhguesit: kufizim i qasjes në materialin zyrtar gjatë procesit.

Në ankesë ka theksuar se pas krahasimit të formularëve zyrtarë të vendvotimeve me ata të QNK, ishte konstatuar mospërputhje e dukshme në pikën 10 të formularëve, që lidhet me votat e paplotësuara dhe ato të pavlefshme. Qendrat e vendvotimeve si në vijim: 0301/01 Gllogoc –

10 vota, SH.F.M.U. "Rasim Kiçina"; 0315/01 Dobroshec – 4 vota, SH.F.M.U. "Rilindja"; 0307/01 Zabel i Ulët – 6 vota, SH.F.M.U. "Arfi Shala"; 0311/02 Tërstenik 1 – 2 vota, SH.F.M.U. "Zenel Hajdini"; 0307/01 Zabel i Ulët – 6 vota, SH.F.M.U. "Arfi Shala"; 0312/02 Tërstenik II – 1 votë, SH.F.M.U. "Dëshmorët e Qëndresës ii"; 0316/02 Gllanasellë – 0 vota, SH.F.M.U. "Xhevë Lladrovci"; 0304/02 Poklek i Ri – 3 vota, IAPP. "Fehmi Lladrovci"; 0314/02 Vërboc – 3 vota, SH.F.M.U. "Dëshmorët e Fortesës"; 0324/01 Arllat – 0 vota, SH.F.M.U. "Abedin Bujupi"; 0318/02 Tërdec – 19 vota, SH.F.M.U. "Shotë Galica"; 0310/02 Komoran – 0 vota, SH.F.M.U. "Xheladin Gashi Plaku"; 0320/01 Shtuticë – 0 vota, SH.F.M.U. "Azem Bejta"; 0317/04 Llapushnik – 3 vota, SH.F.M.U. "Hasan Prishtina"; 0317/03 Tërstenik II – 9 vota, SH.F.M.U. "Dëshmorët e Qëndresës ii"; 0310/03 Komoran – 1 votë, SH.F.M.U. "Xheladin Gashi Plaku"; 0310/02 Komoran – 0 votë, SH.F.M.U. "Xheladin Gashi Plaku"; 0304/01 Poklek i Ri – 4 vota, IAPP. "Fehmi Lladrovci"; 0303/01 Çikatovë e Re – 3 vota, SH.F.M.U. "Ali Gashi"; 0325/01 Fushticë e Poshtme – 6 vota, SH.F.M.U. "24 Korriku"; 0327/01 Korroticë e Epërme – 0 vota, SH.F.M.U. "Shaban Polluzha"; 0329/02 Nekoc – 0 vota, SH.F.M.U. "Bajram Curri"; 0329/03 Nekoc – 0 vota, SH.F.M.U. "Bajram Curri"; 0301/02 Glllogoc – 2 vota, SH.F.M.U. "Rasim Kiçina"; 0315/02 Dobroshec – 5 vota, SH.F.M.U. "Rilindja"; 0302/03 Glllogoc – 6 vota, SH.F.M.U. "Halil Bajraktari".

Faktet e lartcekura përbejnë dyshim të bazuar se votat e raportuara si të paplotësuara në vendvotime mund të jenë plotësuar më pas në QNK në favor të ndonjë kandidati preferencial për Kuvend Komunal, ndërsa numri i votave të pavlefshme ishte rritur në mënyrë të pashpjegueshme, gjë që kishte ndikuar negativisht në rezultatin për kandidat të caktuar. Ankuesi në ankesë deklaroi se kishte mospërputhje të formularëve zyrtarë të vendvotimeve dhe atyre në QNK, ku sipas tij kishte vërejtur mungesë të nënshkrimeve të një ose më shumë anëtarëve të tavolinave të numërimit, konstaton se kishte mungesë të nënshkrimeve në formularët zyrtarë të numërimit, gjë që përbën shkelje të drejtpërdrejtë të rregullave të KQZ-së për dokumentimin dhe vlefshmërinë e formularëve të rezultateve. Gjatë procesit kishte vërejtur dyshime të bazuara se disa nga anëtarët prezent në QNK, pasi kishin vërejtur mospërputhje apo dallime në përmbajtjen e formularit, nuk kishin pranuar të nënshkruajnë fletën përfundimtare për të iu shmangur përgjegjësisë ligjore. Me tutje deklaroi se në disa vendvotime KQZ-ja kishte urdhëruar rinumërim për shkak të parregullsive të konstatuara, ndërsa rezultatet e rinumëruara kishin ndryshuar ndjeshëm. Ky ndryshim tregon qartë se ekziston një dyshim i arsyeshëm se edhe kutitë e tjera mund të jenë prekur nga të njëjtat probleme si vendvotimet 0305/02; 0327/01; 0329/02. Shembull konkret ishte rinumërimi i vendvotimit 0305/02/ në Glllogoc, përfshirë Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin, ku rreth 30 anëtarë të listës së votuesve janë rinumëruar. Nga ato, 26 raste ishin vërejtur ndryshime të rezultateve midis numërimit fillestar në QNK dhe numërimit të rinumëruar në QNR. Ky fakt tregon qartë mospërputhjet që ishin të shtrira dhe nuk mund të kufizoheshin vetëm në vendvotimet ku ishte kryer rinumërimi.

Prandaj, ka kërkuar nga PZAP-i të urdhërojë verifikimin dhe rinumërimin e të gjitha kutive të votimit në Komunën e Glllogocit, me praninë e kandidatëve, të verifikojë përputhshmërinë e formularëve përfundimtarë me fletëvotimet origjinale, të sigurojë mbrojtjen e të drejtës së votuesve dhe kandidatit për transparencë të plotë në proces, të ndërmarrë masa sipas ligjit ndaj çdo personi apo komisioni që ka cenuar integritetin e procesit.

Në përgjigje në ankesë të KQZ-së, ka theksuar se, bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore në nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV.

Në përputhje me nenin e lartcekur, KQZ me datën 24.10.2025, ka marrë vendimin me nr. të protokollit 01/3006/2025 për Miratimin e Rekomandimit pas Procesit të Rinumërimit në QNR, ku ndër vendvotimet e rinumëruara kanë qenë edhe vendvotimet nr.0305/02,0327/01 dhe 0329/02 në komunën e Glllogocit. Pas rinumërimit kanë rezultuar se: Në vendvotimin 0305/02 mospërputhja e rezultateve pas rinumërimit nuk ka ekzistuar; në vendvotimin 0327/01 është rritur të tolerancës +-1, në mënyrë që vendvotimi të procedohet si i rregullt, ndërsa në vendvotimin 0329/02 pas rinumërimit të kutisë tek fletëvotimet e pavlefshme është gjetur një fletëvotim me pas sesa numri i shënuar në QKN dhe kështu më nuk ekziston diferenca.

PZAP, me vendimin ZL.Anr.416/2025, të datës 10.11.2025, ka marrë vendimin për rinumërimin e vendvotimeve që pala i ka cekur në ankesë si në vijim: 0307/01; 0301/04; 0312/2; 0316/02; 0304/02; 0324/01; 0318/02; 0310/02; 0320/01; 0317/04; 0317/03; 0310/03; 0310/02; 0304/01;0325/01;0315/02. Pra, vendvotimet e lartcekura tashmë janë rinumëruar me vendim të PZAP, andaj ankesa e palës lidhur me hetimin dhe rinumërimin e këtyre vendvotimeve nuk qëndron, sepse me rinumërimin e këtyre çështja tashmë është përfunduar dhe rezultatet pas rinumërimit janë përfshirë në rezultatet përfundimtare. Ndërsa, për vendvotimin 0329/02, për të cilin pala ka kërkuar rinumërim, PZAP me këtë vendim e ka refuzuar si të pabazuar.

Gjithashtu lidhur me pretendimet që pala ka ngritur lidhur me administrimin e punës në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN). Sipas nenit 105 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ankesat që kanë të bëjnë me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i ndodhjes së shkeljes së supozuar. Andaj, KQZ ju njofton se procesi i numërimit dhe administrimit të punës së QKN në komunën e Glllogocit ka përfunduar me datë 18.10.2025.

KQZ, pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), fletëvotimeve nga votimi me kusht, fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta dhe fletëvotimeve nga votimi me kusht dhe votimi jashtë Kosovës, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka shpallur rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal, të mbajtura me 12 tetor 2025, për komunën e Glllogocit, me vendim nr.01/3243/2025 të datës 05 nëntor 2025. Në pikën 3 të vendimit KQZ i ka udhëzuar palët që për ankesat eventuale në lidhje

me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendet Komunale, mund të parashtrihen në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e rezultateve, duke filluar nga data 05.11.2025 në ora 15:00. Ndërsa pala e ka dorëzuar ankesën me datën 13.11.2025 në ora 13:44. Pra, jo brenda afatit ligjor si në pikën 3 të vendimit të KQZ.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesa është e pasqfatshme

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Labinot Halilaj, kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga subjekti politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL), me të cilën pretendon se, duhet të ketë hetim dhe rinumërim të tërësishëm të votave për shkak të parregullsive të shumta të evidentuara gjatë dhe pas procesit të votimit e numërimit në Komunën e Glllogocit të cilat kanë rezultuar me vendime të padrejta e të cilat bien ndesh me vullnetin e votuesve dhe cenojnë rëndë demokracinë, të drejtën e votës e cila është e drejtë fundamentale, është e parashtruar pas afatit të përcaktuar ligjor.

Paneli vlerëson se, pala ankuese ankesën e ka parashtruar me datë 13.11.2025, kundër vendimit Nr.01/3243-2025, të datës 05.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal në Glllogoc, ku KQZ rezultatet përfundimtare për Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal në Glllogoc i ka shpallur me datë 05.11.2025 ora 15:00h.

Paneli vlerëson se, pala ankuese ankesën e ka dorëzuar me Postë Private Mik Mik, në zarfin (plikon) e dorëzuar nuk është shënuar data e dorëzimit të ankesës në postë dhe se pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi-prova mbi datën e dorëzimit të ankesës në postë, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 13.11.2025 në ora 13:44 minuta, andaj PZAP si datë të dorëzimit të ankesës e ka marr datën 13.11.2025, pra kur ankesa është dorëzuar në PZAP.

Me dispozitën e nenit 105.1 të LZP-së është paraparë që: “Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.” Po ashtu neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”.

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që “ Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara”, ndërsa nën paragrafi 5.16. parashihet që “Për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR”.

Ndërsa lidhur me pretendimet që pala ka ngritur lidhur me administrimin e punës në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN). Sipas nenit 105 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ankesat që kanë të bëjnë me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda dyzet e tetë (48) orëve nga

momenti i ndodhjes së shkeljes së supozuar. Andaj, edhe sa i përket këtyre pretendimeve vlerësohet se ankesa është pasafatshme për arsye se procesi i numërimit dhe administrimit të punës së QKN në komunën e Gllogocit ka përfunduar me datë 18.10.2025.

Paneli vlerëson se, ankesa e parashtruar nga Labinot Halilaj kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Gllogocit, nga subjekti politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL), ndaj publikimit të rezultateve përfundimtare, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuara me dispozitat e lartcekura, andaj PZAP vendosi që ankesa e ankuesit të hedhet si e pasafatshme, sepse rezultatet përfundimtare nga KQZ janë shpallur më datë 05.11.2025 në ora 15:00, afati për paraqitjen e ankesës ka qenë 48 orë nga shpallja e rezultateve përfundimtare, ndërsa ankesa është paraqitur më datë 13.11.2025 në ora 13:44 minuta, që do të thotë pas afatit të paraparë ligjor.

Pretendimet e tjera të parashtruesit të ankesës, Paneli nuk i ka vlerësuar, sepse secila ankesë fillimisht ekzaminohet në drejtim të lejueshmërisë dhe afatshmërisë dhe nëse rezulton se është e palejueshme apo e pasfatshme PZAP, përkatësisht Paneli e hedh poshtë pa u lëshuar në përmbajtje e ankesës dhe pretendimeve ankimore sikurse në rastin konkret. Të gjitha deklaratimet dhe pretendimet e subjektit ankues edhe sikur të qëndronin apo të merreshin të mirëqena nuk mund të shqyrtohen dhe ekzaminohen meqenëse aspekti i afatshmërisë është veprim paraprak i cili nuk ka mundësi të anashkalohej.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 105 paragraf 1 i LZP-së, nenit 117 paragrafi 3, dhe nenit 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, nenin 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.440/2025, datë 14.11.2025

Kryesuese e panelit
Hidajete Gashi Alaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.